




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Zyrtar Komunal për Integrime Evropiane
Opštinski Službenik za Evropske Integracije
Municipal Officer for European Integration


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštun Upravu

Raporti i Punës
Janar – Dhjetor 2020

-III- Nr. i prot 80 Më 14.01.2021
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

- Zyrtari për Integrime Evropiane, ka kryer funksionin dhe detyrat, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011, për organizimin dhe përgjegjësit e zyrtarit komunal pë integrime evropiane, në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrin e Pushtetit Lokal, Departamentin për Integrime Evropiane.
- Mbikëqyrja aktivitetetve të drejtoreve që burojnë nga PKZMSA-ja, si dhe dokumentet tjera strategjike të MPL-së dhe Qeverisë së Kosovës.
- Obligimet e komunave që dalin nga Agjenda Evropiane, duke u bazuar në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA).
- ZKIE ka marrë pjesë në rishqyrtimin e Planit të Punës së Kolegiumit të zyrtarëve komunal pë integrimeve Evropiane për vitin 2020, në Asociacionin e Komunave të Kosovës.
- Raportimi në MPL për përbushjen e **Obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane**, duke u bazuar në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, Janar-Qershori 2020. Raporti përqendrohet në fushat kryesore të aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike, standardevropiane si dhe rapporti pasqyron gjendjen reale të arriturave të komunave, por njëkohësisht edhe të sfidave përvitet në vijim. Duke pasur parasysh zhvillimin e pandemisë COVID-19 dhe kontributin e komunave në këtë fazë, rapporti përfshin edhe kapitullin e pandemisë COVID-19.
- Në kuadër të **kritereve politike** prezantohet arrija e nivelit lokal në fushat: administratë publike, avokati i popullit, shoqëria civile, lufta kundër terrorizmit, mbrojtja dhe trashëgimia kulturore. Në kuadër të **kritereve ekonomike** prezantohet arrija e nivelit lokal në fushat: ekzistencë e ekonomisë funksionale e tregut, tatimet, ndërmarrjet dhe politikat e industrisë dhe tregu i brendshëm. Në kuadër të **standardeve evropiane**, prezantohet arrija e nivelit lokal në fushat: bujqësi dhe zhvillimi rurale, energjia, gjyqësori dhe të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve, drejtësia, liria dhe siguria, menaxhimi i kufirit dhe migracioni, arsimi dhe kultura, mjedisi dhe mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik. Në kuadër të kapitullit të pandemisë COVID-19 prezantohet menaxhimi i gjendjes së COVID-19 në nivel lokal duke përshtirë masat të cilat janë ndërmarr nga komunat konform udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

- PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT PËR PERSONA TË RIATDHESUAR: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)- Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara(UNDP), mbështetur nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Departamenti për Riintegrin e Personave të Riatdhesuar (DRPR), shpallur dy thirrje, një në muajin Korrik ndërsa tjetra në muajin Nëntor, për personat e riatdhesuar për vitin 2020. Qëllimi i Programit të Vetëpunësimit është të mbështesë personat e riatdhesuar të regjistruar të papunë në krijimin e planeve të realizueshme të biznesit që janë në gjendje t'i mbijetojnë tregut konkurruesh duke promovuar vetëpunësimin si masë aktive të tregut të punës
- Përgjegjës për tërheqjen e PETTY CASH-it 2020: tërheqja e parave nga nënlogarianë banka komerciale, ruajtjen, kryerjen e pagesave për shpenzimet që kërkohen të paguhen në pajtim me rregulloren 01/2013 për shpenzimin e parave publike, evidencën e pranimeve dhe pagesave, klasifikimin e shpenzimeve sipas strukturës së planit kontabël, kërkesën për rimbushje të arkës, kthimi i mjeteve nga avanci për Petty Cash.
- Pjesmarrja në komisione të ndryshme: në rekrutim, prokurim, vlerësimin e pronës komunale për këmbim, për ndarjen bursa, verifikimi i lëshimëve të vërtetimëve pa mbulesë në komunën e Rahovecit, shqyrtimi dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencionëve për ndihma momentale, verifikimin dhe evidentimin e bizneseve joaktive në komunën e Rahovecit etj.
- Pjesëmarrja në punëtoritë të organizaura nga: Ministria e Pushtetit Lokal (MPL), Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe Agjencia Kunder Korruptionit (AKK), njojurit rreth kornizës ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesëve dhe roli i tyre.
- Raportimi në MPL për përbushjen e **Obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane**, duke u bazuar në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, Janar-Dhjetor 2020.
- Procesi i riintegrimit për personat e riadhesuar: Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të përbashkëta, Banimi përmes qirasë, regjistrimi civil dhe pajisja me dokumente personale, përfshirja e të riatdhesuarve në përfitimet nga skemat sociale sipas legjislaciont në fuqi, verifikimin e rasteve në teren në bashkëpunim me kordinatorin regional dhe futja e të dhënave në SMR-në.

Arben Gashi

 Zyrtar Komunal për Integrime Evropiane